

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 1.07.2017

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
Totali	100	

Problemi 1

Everest sh.a bleu 450,000 aksione të zakonshme të Akonkagua sh.a me 1 janar 2015 për €1,540,000.

Në atë datë saldo e fitimeve të mbajtura e Akonkagua sh.a ishte kredi prej €140,000 dhe saldo e rezervave tjera ishte kredi prej of €28,000.

Pasqyra e pozitës financiare të Everest sh.a dhe Akonkagua sh.a me 31 dhjetor 2016 është si në vijim:

	Everest sh.a €000	Akonkagua sh.a €000
Pasuritë:		
Pasuritë jo-qarkulluese:		
Prona, fabrika dhe paisjet	6,720	820
Investimet	<u>2,740</u>	<u>-</u>
	9,460	820
Pasuritë qarkulluese:		
Stoqet	360	170
Të arkëtueshmet tregtare	370	230
Llogaria rrjedhese me Akonkagua sh.a	75	-
Paraja	<u>15</u>	<u>10</u>
Total pasuritë	10,280	1,230
Ekuiteti & Detyrimet:		
Ekuiteti:		
Aksionet e zakonshme 1€ për aksion	5,000	600
Rezervat tjera	200	40
Fitimet e mbajtura	<u>1,210</u>	<u>220</u>
	6,410	860
Detyrimet afatgjata:		
Kredia	3,200	50
Detyrimet afatshkurtera		
Të pagueshmet tregtare	670	270
Llogaria rrjedhese me Everest sh.a	<u> </u>	<u>50</u>
Total Ekuiteti & Detyrimet	10,280	1,230

Informata shtesë:

- i) Investimet në pasqyrën e pozitës financiare të Everest sh.a përfshijnë investimet në Akonkagua sh.a (sipas kostos) dhe investimet në Denali sh.a. Investimet në Denali përbëjnë 10% të kapitalit aksionar të kompanisë në të cilën është investuar.
- ii) Vlera e drejtë e fabrikës së Akonkagua ishte €200,000 mbi vlerën bartëse me 1 janar 2015. Kjo fabrikë duhet të zhvlerësohet përgjatë pesë viteve nga data e blerjes në baza drejtvizore pa vlerë të mbetur. Akonkagua sh.a nuk ka reflektuar këto korigjime në pasqyrat financiare.
- iii) Everest sh.a shiti një fabrikë tek Akonkagua sh.a me 1 janar 2016 për €96,000. Fabrika kishte një kosto prej €100,000 në janar 2015 dhe kishte një vlerë bartëse prej €80,000 me 1 janar 2016.

Fabrika do të zhvlerësohet përgjatë jetës së saj të vlerësuar të mbetur të përdorimit prej katër viteve.
- iv) Everest sh.a shiti mallra tek Akonkagua sh.a me një çmim prej €25,000 me 29 dhjetor 2016 të cilat nuk ishin pranuar nga Akonkagua sh.a deri me 3 janar 2017. Everest sh.a llogarit çmimin shitës duke shtuar një marzhe mbi kosto prej 25%.
- v) Një klient i madh i Akonkagua sh.a ndaj të clit kemi një llogari të arkëtueshme prej €20,000 shkoi në likuidim pak para përfundimit të periudhës raportuese. Nuk ka gjasa që ndonjë pjesë e saldës së mbetur do të arkëtohet. Kontabilisti financiar i Akonkagua sh.a ka harruar ta korigjoj këtë.
- vi) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas pjesës proporcionale të pasurive neto të identifikueshme të degës.
- vii) Everest sh.a teston çdo vit zërin e mirë për dëmtim. Me 31 dhjetor 2016, një dëmtim prej €400,000 ishte identifikuar sa i përket Akonkagua sh.a.

Kërkohe:

Pergadite pasqyrën e konsoliduar financiare të grupit Everest sh.a me 31 dhjetor 2016.

(20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 1

Everest sh.a Pasqyrën e konsoliduar financiare me 31 dhjetor 2016

	€000
Pasuritë:	
Pasuritë jo-qarkulluese:	
PFP $6,720 + 820 + (200 - 80) - 12$	7,648
Paprekshme - zëri i mirë	414
Investimet	<u>1,200</u>
	9,262
Pasuritë qarkulluese:	
Stoqet $(360 + 170 - 5 + 25)$	550
Të arkëtueshmet tregtare $(370 + 230 - 20)$	580
Paraja $(15 + 10)$	25
	<u>1,155</u>
Total pasuritë	10,417
Ekuiteti & Detyrimet:	
Ekuiteti i atribuar pronarve të Everest sh.a	
Aksionet e zakonshme 1€ për aksion	5,000
Rezervat tjera	209
Fitimet e mbajtura	<u>778</u>
	5,987
Interesi jo-kontrollues	<u>240</u>
Total ekuiteti	6,227
Detyrimet afatgjata:	
Kredia $(3,200 + 50)$	3,250
Detyrimet afatshkurtera:	
Të pagueshmet tregtare $(670 + 270)$	<u>940</u>
Total Ekuiteti & Detyrimet	10,417
(i) Struktura e kontrollit:	
Everest	75%
IJK	<u>25%</u>
100%	

Llogaritjet	Të gjitha llogaritjet në	€'000
(ii) Zëri i mirë - Akonkagua sh.a		
Kosto e investimit		1,540
Neto pasuria e blerë:		
Kapitali aksionar	600	
Rezervat tjera	28	
Fitimet e mbajtura	<u>140</u>	
75% interes	968	<u>726</u>
Zëri i mirë		814
Humbja nga dëmtimi		<u>(400)</u>
Saldo në fund		414
(iii) Korigjimet ndërgrupore		
a) Të arkëtueshmet e Everest		75
Stoqet në tranzit		<u>(25)</u>
Të pagueshmet e Akonkaguasë		50
b) FPR - PFP		
Vlera bartëse pas transferit 96 - (96 x 25%)		72
Vlera bartëse sikur te mos ishte transferuar 80 - (20% of 100)		<u>60</u>
		12
(iv) Interesi jo-kontrollues		
Neto vlera e Akonkagua sipas draft PPF		860
Korigjimet:		
Korigjimet e vlerës së drejtë		200
Zhvlerësimi shtesë 20% x 200 x 2vite		(80)
Borxhet e këqija		<u>(20)</u>
		<u>960</u>
25% Interes		240
(v) Fitimet e mbajtura:		
Everest: Saldo në fillim		1,210
FPR: Fabrika		(12)
Stoqet		<u>(5)</u>
		1,193
Akonkagua 75% of (220 - 20 - 80) - 140		
Dëmtimi i zërit të mirë		(15)
Saldo në fund		<u>(400)</u>
		778
(vi) Rezervat tjera		
Everest sh.a		200
Akonkagua 75% e (40 - 28)		<u>9</u>
		209

Problemi 2

Më poshtë është dhënë pasqyra e të ardhurave e Monte Rosa sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016:

	2016
	€ m
Shitjet	143.00
Kosto e mallrave të shitur	<u>(96.60)</u>
Fitimi bruto	46.40
Shpenzimet operative	<u>(28.70)</u>
Fitimi operativ	17.70
Të ardhurat tjera	<u>3.40</u>
Fitimi para interesit dhe tatimit	21.10
Kostot financiare	<u>(5.30)</u>
Fitimi para tatimit	15.80

Informatat në vijim janë në dispozicion:

(i) Shpenzimet operative përfshijnë një shumë prej €0.7 milion që është paguar si gjobë tek ministria e tregtisë dhe industrisë për mospajtueshmëri me ligjin për shoqëri tregtare. Ky shpenzim nuk zbritet për tatime.

(ii) Gjatë vitit, kompania ndau një provizion prej €2.4 milion për dhurata. Pagesa aktuale në llogarinë e dhuratave për punëtorët që largohen ishte €1.6 milion. Vetëm këto pagesa zbriten për tatime.

(iii) Pagesat e lizingut të bëra gjatë vitit arritën shumën në €0.65 milion të cilat përfshijnë kostot financiare prej €0.15 milion. Me 31 dhjetor 2016, obligimet ndaj pasurive nën lizing financiar ishin €1.2 milion. Lëvizjet në pasuritë nën lizing financiar janë si në vijim:

	€ m
Saldo në fillim - 01 janar 2016	2.50
Zhvlerësimi për vitin	<u>(0.7)</u>
Saldo në fund - 31 dhjetor 2016	1.80

(iv) Detajet e pasurive jo-qarkulluese (pa ato nën lizing financiar) në pronësi janë si në vijim:

	Kontabilitet	Tatim
	€ m	€ m
Saldo në fillim - 01 janar 2016	12.50	10.20
Të blera gjatë viti	5.30	5.30
Zhvlerësimi për vitin	<u>(1.10)</u>	<u>(1.65)</u>
Saldo në fund - 31 dhjetor 2016	16.70	13.85

(v) Puna kapitale në progres me 31 dhjetor 2016 përfshin kostot financiare prej €2.3 milion të cilat janë kapitalizuar në pajtim me SNK 23 *Kostot e huamarrjës*. Megjithatë, të gjitha kostot financiare lejohen të zriten sipas ligjit për tatime.

(vi) Detyrimi i tatimit të shtyrë dhe provizioni për dhurata me 1 janar 2016 ishte € 0.55 milion dhe € 0.7 milion respektivisht.

(vii) Norma e aplikueshme e tatimit është 35%.

Kërkohet:

Duke u bazuar në informatat në dispozicion, llogaritni shpenzimet e tatimit aktual dhe të shtyrë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016. (20 pikë)

Zgjidhja e Problemit 2

Llogaritja e shpenzimeve të tatimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

	2016
	€ në milion
Fitimi para tatimit	15.80
Shto: shpenzimet e pa pranuar	
Zhvlerësimi në kontabilitet (€ 1.1 milion + € 0.7 milion)	1.80
Kostot financiare në lizingun financiar	0.15
Gjoha e paguar tek ministria e tregtisë dhe industrisë	0.70
Provizionet për dhuratë	<u>2.40</u>
	5.05
Minus: Shpenzimet e pranueshme €m	
Zhvlerësimi për tatim	(1.65)
Pagesat e lizingut	(0.65)
Pagesat për dhuratë	(1.60)
Kostot e huazimit të kapitalizuara	<u>(2.30)</u>
	(6.20)
Fitimi i tatueshëm për vitin	14.65
Shpenzimet e tatimit aktuale @ 35%	5.13

Llogaritja e shpenzimit të tatimit të shtyrë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

	Vlera bartese €m	Baza tatimore €m	Diferenca e perkohshme €m
Pasuritë jo-qarkulluese - Në pronësi	16.70	13.85	2.85
Pasuritë jo-qarkulluese - Me lizing	1.80	-	1.80
Puna kapitale në progres	2.30	-	2.30
Provizionet për dhuratë (0.7 + 2.4 - 1.6)	(1.50)	-	(1.50)
Obligimet ndaj pasurive nën lizing financiar	(1.20)	-	<u>(1.20)</u>
Total			4.25
Shpenzimi i tatimit të shtyrë @ 35%			1.49
			€ në milion
Detyrimi i tatimit të shtyrë (fillim)			0.55
Shpenzimet e tatimit të shtyrë për vitin (saldo balancuese)			<u>0.94</u>
Detyrimi i tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2016 (€ 4.25 milion x 35%)			1.49

Problemi 3

Bona sh.a është një importues dhe shitës me pakicë i vajrave të bimëve. Ekstraktet nga pasqyrat financiare për këtë vit janë paraqitur më poshtë.

Pasqyrat e të ardhurave për vitet e përfunduara me 30 shtator

	2016	2015
	€000	€000
Shitjet	2,160	1,806
Kosto e shitjeve	<u>(1,755)</u>	<u>(1,444)</u>
Fitimi bruto	405	362
Kostot e shpërndarjes	(130)	(108)
Shpenzimet administrative	<u>(260)</u>	<u>(198)</u>
Fitimi para tatimit	15	56
Tatimi në fitim	<u>(6)</u>	<u>(3)</u>
Fitimi për periudhën	9	53

Pasqyrat e pozitës financiare me 30 shtator

	2016	2015
	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe pasijet	78	72
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	106	61
Të arkëtueshmet tregtare	316	198
Paraja	<u>-</u>	<u>6</u>
	<u>422</u>	<u>265</u>
Total pasuritë	500	337
Ekuiteti dhe detyrimet		
Ekuiteti		
Aksionet e zakonshme	110	85
Aksionet preferenciale	23	11
Premia e aksioneve	15	-
Rezerva e rivlerësimit	20	20
Fitimet e mbajtura	<u>78</u>	<u>74</u>
	246	190
Detyrimet afatshkurtëra		
Mbitërheqja bankare	49	-
Të pagueshmet tregtare	198	142
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>7</u>	<u>5</u>
	<u>254</u>	<u>147</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	500	337

Kërkohet:

a) Llogariti koeficientët në vijim:

- i) Marzhën e fitimit bruto.
- ii) Marzhën e fitimit neto.
- iii) Kthimin në kapitalin e angazhuar
- iv) Qarkullimin i pasurive
- v) Koeficientin e qarkullimit
- vi) Koeficientin e shpejtësisë
- vii) Periudhën e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme
- viii) Peridhën e pagesës së llogarive të pagueshme
- ix) Qarkullimin e stoqeve (15 pikë)

b) Analiza e koeficientëve në vete nuk është e mjaftueshme për interpretimin e pasqyrave të kompanisë dhe ekzistojnë zëra të tjerë informacionesh, të cilët duhet të shikohen.

Kërkohet:

Trego zërat tjerë të informacioneve që duhet të shikohen. (5 pikë)

Zgjidhja e Problemit 3

Koeficientët

	2016	2015
Marzha e fitimit bruto % =		
Fitimi bruto / Shitjet x 100	$405/2,160 \times 100 = 19\%$	$362/1,806 \times 100 = 20\%$
Marzha e fitimit neto % =		
Fitimi neto / Shitjet x 100	$9/2,160 \times 100 = 0.4\%$	$53/1,806 \times 100 = 2.9\%$

Kthimi në kapitalin e angazhuar =

Fitimi para interesit dhe tatimit / (Kapitali aksionar dhe rezervat + Borxhi afatgjatë) x 100

$$15/246 \times 100 = 6\% \qquad 56/190 \times 100 = 29\%$$

Qarkullimi i pasurive =

Shitjet / (Kapitali aksionar dhe rezervat + Borxhi afatgjatë)

$$2,160/246 = 8.8 \text{ herë} \qquad 1,806/190 = 9.5 \text{ herë}$$

Koeficienti i qarkullimit =

Pasuritë qarkulluese / Detyrimet afatshkurtëra

$$422/254 = 1.7 \text{ herë} \qquad 265/147 = 1.8 \text{ herë}$$

Koeficienti i shpejtësisë =

Pasuritë qarkulluese pa stoqet / Detyrimet afatshkurtëra

$$(422 - 106)/254 = 1.2 \text{ herë} \qquad (265 - 61)/147 = 1.4 \text{ herë}$$

Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme =

Të arkëtueshmet tregtare / Shitjet x 365 $316/2,160 \times 365 = 53$ ditë $198/1,806 \times 365 = 40$ ditë

Peridhën e pagesës së llogarive të pagueshme =

Të pagueshmet tregtare / Kosto e shitjeve x 365

$$198/1,755 \times 365 = 41 \text{ ditë} \qquad 142/1,444 \times 365 = 36 \text{ ditë}$$

Qarkullimi i stoqeve =

Stoqet / Kosto e shitjeve x 365 $106/1,755 \times 365 = 22$ ditë $61/1,444 \times 365 = 15$ ditë

b)

- (a) Përmbajtja e çdo komenti shoqërues lidhur me llogaritë dhe pasqyrat e tjera
- (b) Mosha dhe natyra e pasurive të kompanisë
- (c) Zhvillimet aktuale dhe të ardhshme në tregjet e kompanisë, në vend dhe jashtë, përvetsimet ose heqjet e fundit të investimeve nga ana e kompanisë
- (d) Zërat e pazakonshëm, të shpalosur ndaras në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse
- (e) Çdo tipar tjetër i rëndësishëm i raportit dhe pasqyrave, si ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese, detyrimet kontigjente, një raport i kualifikuar i auditorit, pozita tatimore e kompanisë etj.

Problemi 4

Ju jeni emeruar rishtazi Zyrtar Kryesor Financiar i Antero sh.a, një kompani e njohur ndërtimi. Dy transaksionet në vijim kanë tërhequr vëmendjen tuaj:

1. Antero sh.a hyri në një marrëveshje me Elbert Patundshmëri sh.a për të marrë me lizing hapësira të zyrës me 1 prill 2016 për një periudhë fikse prej pesë viteve. Elbert Patundshmëri është përgjegjës për sigurimin, riparimin dhe mirëmbajtjet e pasurisë. Si incentive për lizingmarrësin, lizingdhënësi i dha Antero sh.a-së një periudhë pa pagesë prej një viti që në fillim të marrëveshjes. Më pas, duke filluar nga 1 prill 2017 Antero sh.a do të duhet të bëjë pagesa vjetore në fund të çdo viti të lizingut prej of €180 milion.

2. Antero sh.a hyri në një marrëveshje tjetër të lizingut me 1 tetor 2016 me Rainier Financa sh.a. Marrëveshja ishte që të mirrej me qira një makinë për prodhimin e tullave e cila kishte çmim të tregut prej €2,000 milion. Makinaria ishte modifikuar pak për përdorim nga Antero sh.a, kostoja e të cilës ishte përfshirë në pagesat e qirasë. Antero sh.a është përgjegjëse për të siguruar makinerinë përgjatë periudhës së lizingut dhe do të marrë përsipër kontrollet e rregullta të mirëmbajtjes. Lizingu kërkon pesë pagesa vjetore të qirasë prej €500 milion të paguara në fillim duke filluar nga 1 tetor 2016. Antero sh.a pritet që të kthejë makinerinë në fund të periudhës pesë vjeçare. Ky lloj i lizingut ka një normë të nënkuptuar të interesit prej 12.5%.

Kërkohet:

- (a) Shpjego karakteristikat kryesore të lizingut financiar dhe lizingut operacional dhe trego duke i përmendur arsyet se si të dy lizingjet e Antero's duhet të kategorizohen sipas SNK 17 Lizingjet. (10 pikë)
- (b) Përgaditi ekstraktet e pasqyrave financiare të Antero sh.a për vitin e përfunduar me 31 mars 2017. (10 pikë)

Zgjidhja e Problemit 4

(a) Lizingu është një marrëveshje për të marrë me qira një pasuri ndërmjet lizingdhënësit (pronarit) dhe lizingmarrësit (përdoruesit). Lizingu është një teknikë e shpeshtë dhe me e lirë e financimit të pasurive.

SNK 17 identifikon dy lloje të lizingjeve

(i) Lizingu operativ

- Kjo është një marrëveshje ndërmjet lizingdhënësit dhe lizingmarrësit për të marrë nën lizing një pasuri ku titulli ligjor dhe kontrolli mbetet me qiradhënësin.
- Rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë mbeten tek lizingdhënësi.
- Lizingu paguan një tarife për përdorimin/punësimin e pasurisë që njihet si qira.
- Qiratë nga lizingmarrësi do të trajtohen si shpenzim në baza drejtvizore përgjatë kohës së lizingut.
- Lizingdhënësi i trajton qiratë si të hyra në librat e tij.

(ii) Lizingu financiar

Është një marrëveshje për të marrë me qira një pasuri ku lizingdhënësi substancialisht transferon rreziqet dhe shpërblimet lidhur me pronësinë e pasurisë tek lizingmarrësi.

Karakteristikat kryesore të lizingut financiar

- Qiradhënësi transferon pronësinë e pasurisë tek lizingmarrësi në fund të periudhës së lizingut.
- Lizingmarrësi ka opcionin e blerjes së pasurisë më një çmim që pritët të jëtë më i ulët se vlera e drejtë.
- Kohëzgjata e lizingut është për pjesën më të madhe të jetës ekonomike të pasurisë.
- Në fillim të lizingut, VT e PML (pagesave minimale të lizingut) arrin shumën prej së paku pjesës substanciale të vlerës së drejtë të pasurisë.
- Pasuria nën lizing është e natyrës së specializuar ashtu që vetëm lizingmarrësi mund ta përdorë pa u bërë modifikime të mëdha.

Lizingu me Rainier Finance duhet të kategorizohet si lizing financiar në pajtim me SNK 17 *Lizingjet* dhe rreziqet dhe shpërblimet e shoqëruara me pronësinë e pasurisë janë transferuar tek lizingmarrësi (p.sh. Antero paguan sigurimin, riparimin dhe mirëmbajtjen për përdorim dhe e përdor pasurinë përgjatë jetës ekonomike). Për më tepër, makineria është modifikuar për përdorim nga Antero që do ta bënte më të vështirë shitjen/ridhënien me qira nga kompania e lizingut.

Lizingu me Elbert Patundshmëri është një lizing operativ. Kjo për shkak së lizingdhënësi (Elbert Patundshmëri) duket së do të jetë përgjegjës për rrezikun e pronësisë pasi që është përgjegjës për kostot e mirëmbajtjes, sigurimit dhe riparimit.

(b) Ekstraket e pasqyrave financiare të Antero sh.a për vitin e përfunduar me 31 mars 2017

Ekstrakt i pasqyrës së të ardhurave

	€'m
Qiratë e lizingut operativ (€720m/5 vite) (L14)	144
Shpenzimet e zhvlerësimit (L12)	200
Kosto financiare (L13)	93.75

Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare

	€'m	€'m
Pasuritë jo-qarkulluese		
Kosto (L1)		2,000
Zhvlerësimi i akumuluar (L12)		<u>(200)</u>
		1,800
Detyrimet afatgjata		
Obligimet sipas lizingut financiar (L13)		1,187.5
Detyrimet afatshkurtëra		
Interesi i përlllogaritur (L13)	93.75	
Obligimet sipas lizingut financiar (L13)		
(1,593.75 - 1,187.5 - 93.75)	<u>312.5</u>	
		406.25
Lizingu operativ i pagueshëm		144

Llogaritjet

(L11) Njohja fillestare e pasurisë dhe detyrimit sipas lizingut

D	Pasuritë jo-qarkulluese kosto	€2000m	
K	Obligimet sipas lizingut financiar		€2000m

(L12) Zhvlerësimi

D	Shpenzimet e zhvlerësimit	€200m	
K	Zhvlerësimi i akumuluar		€200m
		(2000m/5 × 6/12)	

(L13) Detyrimi i lizingut financiar - kosto e amortizuar (shumat në €'m)

Viti	Në fillim	Qiraja	Kryegjëja		Interesi 12.5 % (6/12)	Bartur 31/3/2017	Interesi 12.5% (6/12)	Bartur 30/9/2017
			Saldo					
1	2,000	(500)	1,500		93.75	1,593.75	93.75	1,687.50
2	1,687.50	(500)	1,187.50					

(L14) Lizingu operativ

Kostoja totale e lizingut të hapësirave për zyre është e barabartë me €720 milion (i.e. €180m x 4 vite). SNK 17 *Lizingjet* thotë që kostoja totale e lizingut të një pasurie të marrë nën lizing operativ që përfshin periudhën pa pagesë të qirasë duhet të shpërndahet përgjatë tërë periudhës së lizingut për të barazuar të hyrat nga okupimi i hapësirave të zyrës me kostot që i shoqërojnë. Andaj shpenzimet e lizingut operativ do të jenë €144m (€720/5 vite).

Problemi 5

(a) Jezercë Airlines është një kompani vendore shqiptare e linjave ajrore e formuar rishtazi, e cila është kontraktuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë për të ofruar 6 fluturime ditore; 2 fluturime ditore në Ballkanin Lindor, 3 fluturime ditore në Ballkanin Perendimor dhe 1 fluturim ditor në Evropë.

Jezercë Airlines mund të identifikoj rrjedhat e parasë që gjenerohen nga secili prej këtyre linjave të fluturimeve dhe secila prej këtyre linjave të fluturimeve ka pasuri të identifikueshme ndarazi.

Të gjitha linjat e fluturimeve operojnë me fitim me përjashtim të linjës së 3 fluturimeve ditore në Ballkanin Perendimor e cila operojnë me humbje. Vlera e agreguar bartëse e pasurive e përdorur nga Jezercë Airlines për të operuar linjat e kontraktuara të fluturimeve është €7,000 milion. Vlera e agreguar neto e realizueshme e pasurive është €5,900 milion dhe vlera e tanishme e rrjedhave të parasë nga linjat e fluturimit është aktualisht €9,800 milion.

Kërkohet:

- (i) Shpjego se çfarë është një njësi gjeneruese e parasë dhe trego duke i përmendur arsyet se sa njësi gjeneruese të parasë i ka Jezercë Airlines. (3 pikë)
- (ii) Trego dallimin ndërmjet 'shumës së rikuperueshme' dhe 'vlerës në përdorim' të një pasurie. (2 pikë)
- (iii) Trego duke i përmendur arsyet, shumën e ndonjë humbje nga dëmtimi të pasurive të linjave ajrore të fluturimit, dhe vlerën me të cilën ato duhet të raportohen në pasqyrën e pozitës financiare të Jezercë Airlines. (3 pikë)

(b) Viti i Nemërçka sh.a's përfundon me 31 dhjetor. Nemërçka sh.a bleu një makineri me 1 janar 2016 për €200,000. Jeta ekonomike e përdorimit të makinerisë është vlerësuar 4 vite me vlerë mbetese zero. Me 30 shtator 2016, Nemërçka sh.a vendosi të shesë makinerinë. Megjithatë, pasuria nuk është shitur deri me 31 dhjetor 2016 por është pritur se do të shitet deri me 30 prill 2017. Vlera e drejtë minus kostot e shitjes e makinerisë ishte €180,000 edhe me 30 shtator edhe me 31 dhjetor 2016.

Kërkohet:

- (i) Shpjego rregullat e matjes për Pasurite jo-qarkulluese të mbajtura për shitje sipas SNRF 5. (3 pikë)
- (ii) Duke supozuar që kriteret për klasifikim të pasurisë të mbajtur për shitje janë përmbushur, trego shumat të cilat duhet të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave të Nemërçka sh.a's për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 dhe vlerën në pasqyrën e pozitës financiare në po atë datë. (4 pikë)

(c)

(i) SNK 18 'Të hyrat', ka të bëjë me njohjen e të hyrave të entiteteve raportuese.

Kërkohet:

Trego parimet e SNK 18 për njohjen e të hyrave nga kryerja e shërbimeve. (2 pikë)

(ii) Supozo që Papingu sh.a furnizon një klient me një produkt për një çmim total prej €80,000. Çmimi përfshin servisim 'pa pagesë' të produktit për dy vite. Papingu sh.a vlerëson që kosto vjetore e servisimit të produktit do të jetë €9,600 dhe zakonisht fiton një prej 20% në të hyrat nga shërbimet.

Kërkohet:

Trego të hyrat e Papingu sh.a që duhet të njihen nga kryerja e shërbimeve në skenarin e mësipërm.

(3 pikë)

[Total: 20 pikë]

5.

i) Kontrata e Jezercë Airlines me qeverinë

i) SNK 36 Dëmtimi i pasurive e definojnë një njësi gjeneruese të parasë si grupi më i vogël i identifikueshëm i pasurive që gjenerojnë rrjedha hyrëse të parasë të cilat janë shumë të pavarura nga rrjedhat e parasë nga pasuritë tjera apo grupe të pasurive.

Numri i njërive gjeneruese të parasë varet nga kontrata që Jezercë Airlines ka me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Nëse që të tri destinacionet duhet të operojnë në një kontratë, atëherë kemi vetëm një njësi gjeneruese të parasë. Kjo për shkak se rrjedhat e parasë të secilës linjë të fluturimit nuk janë të pavarura edhe pse mund të maten ndarazi. Andaj, dëmtimi duhet të vlerësohet për të gjitha gjashtë linjat e fluturimit si një njësi e vetme gjeneruese e parasë.

Në mënyrë alternative, nëse janë tri kontrata, një për fluturimet në Ballkanin Lindor, një për fluturimet në Ballkanin Perëndimor dhe një për fluturimet në Evropë, atëherë do të kishim tri njësi gjeneruese të parasë. Në këtë rast, fluturimet në Ballkanin Perëndimor mund të jetë e dëmtuar si një njësi gjeneruese e parasë.

ii) Shuma e rikuperueshme është më e larta e vlerës së drejtë minus shpenzimet e shitjes së një pasurie (pra vlera e saj neto e realizueshme) dhe vlera në përdorim. Vlera në përdorim është vlera e tanishme e rrjedhave të ardhshme të parasë që priten të gjenerohen nga një pasuri nga përdorimi i vazhdueshëm i saj e jo nga shitja.

iii) Shuma e rikuperueshme e linjave është më e larta e €5,900m (vlera neto e realizueshme ose vlera e drejtë minus shpenzimet e shitjes) dhe €9,800m (vlera në përdorim) pra €9,800m. Pasi që kjo është më e lartë se vlera bartëse e pasurive prej €7,000m nuk ka dëmtim dhe vlera bartëse duhet të vazhdojë të bazohet në €7,000m.

(b)

i) SNRF 5 thotë që pasuritë jo-qarkulluese (ose grup i shlyerjes) të klasifikuara si të mbajtura për shitje maten sipas vlerës më të ulët të:

- Vlerës bartëse; dhe
- Vlerës së drejtë minus shpenzimet e shitjes.

Çdo humbje nga dëmtimi që rrjedh nga riklasifikimi llogaritet si pasuri jo-qarkulluese normale (SNK 16). Pasuritë jo-qarkulluese/grupet e shlyerjes të klasifikuara si të mbajtura për shitje nuk zhvlerësohen.

ii) Në pasqyrë e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016, shpenzimet e zhvlerësimit do të jenë €37,500 ($25\% \times €200,000 \times 9/12$) që është për 9 muaj deri me 30 shtator 2016. Nuk do të ketë zhvlerësim për 3 muajt e fundit pasi që pasuria ishte klasifikuar si 'e mbajtur për shitje' efektive prej 1 tetor 2016.

Me 30 shtator 2016 pasuria do të matet sipas vlerës bartëse prej €162,500 (€200,000 kosto, minus zhvlerësimi €37,500), e cila është më e ulët se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e

shitjes prej €180,000. Shuma e njejtë do të reflektohet në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2016 si një pasuri qarkulluese.

Nuk do të ketë humbje nga dëmtimi me 30 shtator 2016.

(c)

i) Njohja e të hyrave për kryerjen e shërbimeve

SNK 18 thotë që 'në kohën kur rezultati i një transaksioni që ka të bëjë me kryerjen e shërbimeve mund të vlerësohet me besueshmëri, entiteti duhet të njohë të hyrat që kanë të bëjnë me këtë transaksion duke iu referuar shkallës së përmbushjës së transaksionit në fund të periudhës raportuese. Me fjalë të tjera, të hyrat njihen gradualisht, e jo të gjitha përnjeherë. SNK 18 gjithashtu thotë që rezultati i transaksionit mund të matet me besueshmëri kur të gjitha kushtet në vijim janë përmbushur:

1. Shuma e të hyrave mund të matet me besueshmëri.
2. Ka shumë mundësi që përfitimet ekonomike që kanë të bëjnë me transaksionin do të hyjnë në entitet;
3. Faza e kompletimit të transaksionit në fund të datës raportuese mund të matet me besueshmëri.
4. Kostot që kanë ndodhur për këtë transaksion dhe kostot për të përmbushur (kompletuar) transaksionin mund të maten me besueshmëri.

ii) Të hyrat që duhet të njihen nga by Papingu sh.a për kryerjen e shërbimeve:

Kostoat e pritura totale e Papingu sh.a për kryerjen e 'shërbimeve pa pagesë' është €19,200 (2 x €9,600). Duke marrë marzhën normale për punët e shërbimit, kjo na jep të hyrat prej €24,000 ($€19,200 \times 100 \div 80$). Andaj, Papingu sh.a do të njohë të hyrat nga shitja e produktit prej €56,000 ($€80,000 - €24,000$) në datën e furnizimit dhe të hyra nga shërbimi prej €24,000 përgjatë dy viteve pas furnizimit.